



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezuar Primi / Prodato Received / Delivered	07-06-2023	3	viti god. year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHIK	4620/2023		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.691/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr 691/2023 të datës 28.04.2023 të parashtruar nga ankuesja , me adresë Rr" Lidhja e Prizrenit" Komunën e Suharekës, kundër masës disiplinore „Vërejtje me gojë“ të shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhetit dhe Financa, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 07.06.2023 mori këtë:

### V E N D I M

- I. **APROVOHET** ankesa me numër A.nr.691/2023 e datës 28.04.2023 e parashtruar nga ankuesja .
- II. **ANULOHET** masa disiplinore „Vërejtje me gojë“ me numër referencë 01/104-24740 e datës 14.04.2023 e shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa.
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankueses në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa në Komunën e Suharekës me datën 14.04.2023 ka marr Vendimin me numër 01/104-24740 me të cilën ankueses

e punësuar në Komunën e Suharekës sipas Akt Emërimit 01-Nr-101-26698 të datës 19.06.2017 në pozitën “Zyrtare për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme, i ka shqiptuar vërejtjen me gojë për mos respektimin e orarit të punës.

Ankuesja e pa kënaqur me “Vërejtjen,, me numër 01/104-24740 të datës 14.04.2023 të shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet Financa në Komunën e Suharekës, me datën 28.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendim se vendimi lidhur me shqiptimin e “masës disiplinore,, ka shkelje të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të ligjit material si dhe e njëjta pretendon se vërejtja i është shqiptuar nga personi jo kompetent .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.05.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Komuna e Rahovecit. Ndërsa Këshilli më datë 10.05.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 3915/2023 të datës 28.04.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me goje me numër të protokollit 01/104-24740 të datës 14.04.2023 të shqiptuar nga Drejtori i Ekonomisë dhe Financave; Kërkesën për përgjoje në ankesë të datës 04.05.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 10.05.2023; Akt emërimit me numër 01-Nr.101-26698 të datës 19.02.2017; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës “Zyrtar për vlerësimin e pronës së paluajtshme,, Emalin e datës 02.06.2023 të A.Hoxha drejtuar I. Mehmeti; Formularin për Vlerësimin e detyrave të punës të datës 31.12.2021; Formularin për Vlerësimin e rezultateve në punës të datës 25.01.2023; Emalin e datës 06.06.2023 të A.Hoxha drejtor I.Mehmeti; Organogramin e Komunës së Suharekës; Vendimin për Organizimin e Brendshëm të Administratës në Komunën e Suharekës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses, është e bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit në bazë të provave të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit ka gjetur se Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa në Komunën e Suharekës me datën 14.04.2023 ankueses Shqipe Berisha-Bytyqi e punësuar në Komunën e Suharekës sipas Akt Emërimit 01-Nr-101-26698 të datës 19.06.2017 në pozitën “Zyrtare për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme “, në Sektorin e Tatimit në Pronë i ka shqiptuar masën disiplinore ,, Vërejtje me gojë” për mos respektimin e orarit të punës me arsyetim që: “...ankuesja që disa here nuk kërkon leje për punë jashtë komunës nga Shefi i Sektorit dhe nga unë si Drejtor, dhe e njëjta nuk e respekton hierarkinë dhe ka vonesa të herëpashershme në punë .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se shqiptimi i masës disiplinore “vërejtje me gojë”, me datë

14.04.2023 nga Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa në Komunë e Suharekës me numër protokolli 01/104-24740, i është shqiptuar pa vërtetuar bazën ligjore dhe pa vërtetuar gjendjen faktike dhe juridike, e cila thekson se është nxjerrë në kundërshtim me Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Rregullores (QRK)Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, dhe të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe e njëjta pretendon se vërejtja i është shqiptuar nga personi jo kompetent dhe i propozon Këshillit që ti aprovohet ankesa dhe të anulohet vërejtja e datës 14.04.2023 e shqiptuar si e paligjshme.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke marr parasysh dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 46 paragrafin 4 nën paragrafin 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 ku janë përcaktuar shkeljet e lehta të detyrave të punës si : *Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. nungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar dhe neni 47 i këtij ligji i cili ka paraparë masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”, si dhe neni 50 paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohen masat disiplinore për shkelje të lehta dhe të rënda se: „Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji”, dhe „ 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji”, ka konstatuar që në rastin konkret duke u bazuar në provat e lëndës, masa disiplinore e shqiptuar është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartëcekura, pasi që masa e shqiptuar nuk është e përcaktuar me dispozitat ligjore të lartëcekura, gjegjësisht dispozitat ligjore për procedurën disiplinore nuk kanë paraparë një masë të tillë disiplinore „Vërejtje me gojë” për shkelje disiplinore”. Po ashtu në rastin konkret Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa në Komunë e Suharekës me rastin e shqiptimit të „vërejtjes me gojë” për ankuesen nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike duke mos i konstatuar drejt elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht nuk ka konstatuar saktë përgjegjësin disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ku theksohet se: “Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”, e që në rastin konkret, Kolegji konstaton se Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa në Komunë e Suharekës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankueses përveç që nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike ai nuk ka arritur të vërtetoj as gjendjen juridike sepse në „vërejtjen me gojë” nuk i është referuar asnjë dispozite të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, respektivisht nuk ka konstatuar shkeljet e kryera nga ankuesja, gjegjësisht nuk ka konstatuar që me veprimet apo mos veprimet e saj gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ka bërë shkelje të lehta apo të rënda-serioze të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë.*

Kolegji i Këshillit ju referua po ashtu nenit 48 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka përcaktuar kompetencat për shqiptimin e masave disiplinore gjegjësisht paragrafi 1 i këtij neni i cili ka përcaktuar që: *"Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë"*, ndërsa neni 8 paragrafi 2 i Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: *"Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit"*, bazuar në këtë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar nenin 47 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, konstaton se masën disiplinore *"Vërejtje"*, ka kompetencë t'a shqiptoj vetëm mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, kjo ndërlidhet me paragrafin 2 të nenit 48 të këtij ligji, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*, në rastin konkret në bazë të përgjigjes në ankesë të datës 10.05.2023 dhe provave shtesë të datës 06.06.2023 të dërguar nga Udhëheqësi i Personelit në Komunën e Suharekës, respektivisht në pyetjen - *se kujt i raporton drejtpërdrejtë ankuesja*, ka sqaruar duke deklaruar se citoj: *"Sa i përket se kujt i raporton ankuesja i raporton menaxherit të Sektorit të Tatimit në Pronë në Drejtorinë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa në Komunën e Suharekës"* që në fakt në bazë të deklaramit të Udhëheqësi të Personelit të Komunës së Suharekës dhe në bazë të provave të bashkangjitura në përgjigje, konkretisht përshkrimit të detyrave të punës për pozitën *"Zyrtar/e për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme"*, rezulton se ankuesja e cila ushtron këtë pozitë sipas Akt Emërimit 01-Nr-101-26698 të datës 19.06.2017 mbikëqyrës të drejtpërdrejtë e ka Menaxherin e Sektorit të Tatimit në Pronë, andaj si rrjedhojë, Kolegji vlerëson se Drejtori i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa në Komunën e Suharekës nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore *"Vërejtje me gojë"*, sepse në bazë të provave materiale nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankueses edhe pse i njëjti është në pozitë Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa, por që ankuesja nuk i raporton dhe se i njëjti ka ndërhyrë direkt në kompetencat e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore *"Vërejtje me gojë"* me numër protokolli 01-104-24740 e datës 14.04.2023 e shqiptuar nga Drejtori për Ekonomi, Buxhet dhe Financa ndaj ankueses është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe 8 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Po ashtu masa disiplinore *"Vërejtje me gojë"* e shqiptuar ndaj ankueses është në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si e tillë është e paligjshme, andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara.

Si u tha më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se obligohet Kryetari dhe Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Suharekës, që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankueses në pajtim me këtë vendim.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në diapozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23

dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 në paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nënin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.691/2023

Ilire MEHEMTI-SHAQIRI

  
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses;
- Kryetarit të Komunës së Suharekës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.